

Aneksi 7

FTESË PËR OFERTË

Emri: Instituti për Politika Zhvillimore INDEP
Adresa: Rr. ‘Fehmi Agani’, Nr. 50 A/4
Kodi Postar 10000, Prishtinë, Kosovë
E-mail: office@indep.info
Afati i dorëzimit të ofertës: 6 prill 2024

Instituti për Politika Zhvillimore INDEP po zbaton projektin “*Të rinjtë për një të ardhme të qendrueshme*” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur komunat në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese, më së largu deri më 6 prill 2024, në adresën e e-mailit: office@indep.info ose në adresën postare Rr. ‘Fehmi Agani’, Nr. 50 A/4, Kodi Postar 10000, Prishtinë, Kosovë. Ofertat e pranuar pas këtij afati, konsiderohen të pavlefshme.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, INDEP do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktin sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i produktit	Sasia	Çmimi/njësi Me TVSH (ALL)
1.	Pemë <i>Prunus cerasifera</i>	25	
2.	Pemë <i>Cupressus arizonica</i>	25	
3.	Transport	1	
	Totali		

Specifikime të përgjithshme teknike:

- Pemë *Prunus cerasifera*, dru gjetherënës me gjethe ovale me ngjyrë kumbulle në të kuqe, lartësi 1,5 – 2 m, (mosha 4-5 vjet), 25 cope
- Pemë *Cupressus arizonica*, dru halor me madhësi mesatare që rritet në formë piramide dhe që qëndron gjatë gjithë vitit i gjelbër, lartësi 1,5 – 2 m, (mosha 4-5 vjet), 25 cope
- Transport për pemët, 1 rrugë deri në lokacionin e përcaktuar në komunën e Fushë Kosovës
- Ofrimi i këtij shërbimi kërkohet për periudhën **Prill-Maj 2024**. Me Subjektin fitues do të lidhet një kontratë.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e Komunës së Fushë Kosovës;
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email office@indep.info brenda datës 6 prill 2024 ose në adresën postare Rr. ‘Fehmi Agani’, Nr. 50 A/4, Kodi Postar 10000, Prishtinë, Kosovë. **Nuk pranohen ofertat dorazi.**
- 4) Pagesa e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesin të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në EURO, me TVSH të përfshirë në çmim, por gjithashtu edhe me vlerë pa TVSH, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Çertifikatë Regjistrimi nga ARBK;
- 2) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër.
- 3) Numrin e llogarisë bankare.
- 4) Certifikate origjine dhe fitosanitare për pemë.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.